



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave dhe Transfereve
Ministarstvo za Finacije i Transfere / Ministry of Finance and Transfers

Nr.
Datë: 19.03.2020

Në mbështetje të nenit 8, paragrafi 1.4, të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, me qëllim të zbatimit të Vendimit Nr. 01/07 dhe 01/09 të Qeverisë së Republikës së Kosovës për marrjen e masave shtesë pas konfirmimit të rasteve pozitive me Corona Virus COVID 19, Ministri i Financave dhe Transfereve merr këtë:

VENDIM

1. Zgjatet deri në 30 Prill 2020 afati për dorëzimin e deklaratave, raporteve dhe pagesave të detyrimeve tatimore si dhe trajtimi dhe vendosja lidhur me kërkesat për rimbursime, që ndërlidhen me zbatimin e legjislacionit tatimor në fuqi, si në vijim:

1.1. Ligjit Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, i plotësuar dhe ndryshuar;

1.2. Ligjit Nr. 05/L-028 për Tatimin në të Ardhurat Personale;


1.3. Ligjit Nr. 06/L-105 për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave; dhe

1.4. Ligjit Nr. 05/L -037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar.

2. Ky Vendim do të zbatohet për të gjithë tatimpaguesit - personat fizik dhe juridik privat (punëdhënës, korporatë, shoqëri tregtare, organizatë jo qeveritare dhe të ngjashme), pa përfshirë sektorin publik.

3. Obligohet Administrata Tatimore e Kosovës për zbatimin e këtij Vendimi.

4. Vendimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit.


Besnik Bislimi
Ministër i Financave dhe Transfereve

Vendimi i dërgohet:

- ATK-së;
- Departamentit të Politikave Fiskale; dhe
- Arkivit të Ministrisë;